

ASAMBLEA E JASHTEZAKONSHME E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE
KUFIZUAR "KAVAJA ACQUACULTURE PRODUCTIONS" ME INICIALE
"K.A.P." Sh.p.k.,
ME QENDER NE KAVAJE, NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

Sot, me date 19 prill 2002, ora 16:00, prane selise ligjore ne lagjen nr. 3 Kavaje, jane mbledhur ortaket qe perfaqsojne te gjithe kapitalin e shoqerise "K.A.P." Sh.p.k. per te diskutuar mbi rendin e dites si vijon:

1. Doreheqja e Keshillit Administrativ;
2. Emerimi i Administratorit te ri
3. Ndryshimi i nenit statutor per zevendesimin e Keshillit Administrativ me nje Administrator te Vetem.

Jane te pranishem: Z. Marcello Aloisi, si perfaqses i shoqerise Turisma S.r.l., nepermjet procures se posacme te dates 16 prill 2002; Z. Kujtim Katroshi, perfaqses i ortakut shtet. Kryeson asamblene z. Kujtim Katroshi, dhe emerom sekretar z. Roggia Savino R., qe pranon. Kryesuesi i asamblese hap mbledhjen duke lexuar doreheqjet e anetareve te Keshillit Administrativ te "K.A.P." Sh.p.k., dhe perkatesisht te presidentit te Keshillit Administrativ z. Pietro Luchetta, te anetarit Dario Carrugi, te anetares Silvana Menigatti, te anetarit Massimo Vianello dhe te anetarit Kujtim Katroshi.

Asambleja pasi diskutoi mbi ceshtjen ne fjale, unanimisht, pranon doreheqjet e te gjithe anetareve te Keshillit Administrativ si me siper.

Duke kaluar ne piken e dyte te rendit te dites, merr fjalen z. Aloisi, i cili propozon mbi emerimin e nje Administratori te Vetem, ne vend te nje Keshilli Administrativ, per te lehtesuar administrimin e shoqerise, ne kuadrin e ristrukturimit dhe riorganizimit te saj.

Kryesuesi i mbledhjes, ne kuadrin e propozimit te ri, hedh ne vote propozimin e z. Aloisi, duke e propozuar kete te fundit si Administrator i Vetem.


Mbjedhja me unanimitet pranon ndryshimin e lartepemendur dhe deklarom z. Marcello Aloisi Administrator te ri e te Vetem te shoqerise. Ky i fundit nga ana e tij pranon detyren dhe falenderom per besimin.

Duke kaluar ne piken 3 te rendit te dites, Asambleja ngarkom administratorine ri per te ndjekur te gjitha procedurat e nevojshme per ndryshimin e neneve perkates te statutit.



Duke mos patur ceshtje te tjera per diskutim, ne oren 18:00, kryesuesi i mbledhjes se Asamblese e deklarom te mbyllur ate.

Ky vendim i Asamblese redaktohet ne gjuhen shqipe dhe ate italiane dhe firmoset rregullisht nga Kryesuesi i mbledhjes se Asamblese dhe Sekretari i saj.


Sekretari
Roggia Savino R.



Kryesuesi i mbledhjes se asamblese
Kujtim Katroshi



Kryesuesi: L. P. P. P.
Kujtim Katroshi



118

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 2142 Rep.
Nr. 1048 Kol.



VENDIM I ASAMBLESE SE ORTAKEVE
TE SHOQERISE
KAVAJA ACQUACULTURAL PRODUCTION SHPK.

SOT NE TIRANE ME DATE 13.04.2007 NE PRANINE TIME NOTERIT TE DHOMES SE
NOTEREVE TIRANE, PRANE MINISTRISE SE EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJITIKES, ORA
09.00, U MBLODH ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE KAVAJA ACQUACULTURAL
PRODUCTION SHPK. (K.A.P SHPK.), REGJISTRUAR PRANE REGJISTRIT TREGTAR ME VENDIM
TE GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR TIRANE NR. 6987 DATE 27.09.1993, PER TE VENDOSUR
MBI RENDIN E DITES SI ME POSHTE:

1. Relacion i Administratorit;
 2. Miratim i bilancit per vitin 2006;
 3. Miratim i shitjes tek te tretet i 82.5% te kuotave te zoteruara nga ortaket private;
 4. Doreheqje e administratorit dhe zevendesim i tij;
 5. Te ndryshme;
- Janë të pranishëm ortakët:

- Ortaku Marcello Aloisi, shtetas italian, lindur me 08.07.1944 ne Sogliano Cavour (Lecce), me nënshtetësi italiane, mbajtës i pasaportës nr. Y028532, zotërues i 27.5% te kapitalit te shoqërisë KAP Shpk.;
 - Ortaku Massimo Carnevali, shtetas italian, lindur ne Rome, Itali me date 03.05.1957, , zotërues i 27.5 % te kapitalit te shoqërisë KAP Shpk., i përfaqësuar me prokure te posaçme nr. 3253 rep dhe nr. 590 kol te noterit Agim Robo (prokura bashkëngjitur);;
 - Ortaku Francesco Roggia, i biri i Savino Raimondo, lindur ne Foggia me 02.03.1982, zotërues i 27.5 % te kapitalit te shoqërisë KAP Shpk. përfaqësuar me prokure nga ortaku Marcello Aloisi (prokura bashkëngjitur);
 - Ortaku Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes, zotëruese e 17.5% te kapitalit te shoqërisë KAP Shpk., përfaqësuar nga Valentine MURRASHI ne baze te autorizimit nr 2225/2, date 13.04.2007, (autorizimi bashkëngjitur).
- Kryeson Asamblenë, ortakë Marcello Aloisi, Administrator i Vetëm i shoqërisë. Kryetari, pasi konstatoi se është i pranishëm i gjithë kapitali i shoqërisë, deklaroi Asamblenë e Ortakeve te KAP Shpk. ligjërisht te mbledhur. Ortaket pranojnë dhe miratojnë shprehimisht qe mbledhja te behet prane Ministrise se Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes ndryshe nga sa ishte parashikuar ne njoftim.

mi

AE

Amolez

Kryetari informon Asamblenë mbi rendin e ditës dhe të gjithë ortaket deklarojnë se e njohin, kanë marre dijeni për dokumentacionin shoqërues dhe se pranojnë të marrin në shqyrtim pikat e rendit të ditës sipas radhës së paraqitjes.

Merr fjalën administratori i shoqërisë i cili ekspozon aktivitetin e shoqërisë gjate vitit të shkuar dhe informon asamblenë mbi të dhënat e bilancit të vitit ushtrimor 2006. Me pas administratori informon ortakte mbi të gjitha shitjet e kuotave të kryera nga secili prej ortakeve italiane tek Z. Albano Aliko. Gjithashtu, pas mbylljes së bilancit të vitit ushtrimor 2006 dhe pas shitjes së kuotave të shoqërisë tek Z. Albano Aliko, Administratori Z. Marcello Aloisi shpreh vullnetin e tij për të dhënë dorëheqjen nga detyra e administratorit të shoqërisë.

Pas diskutimesh, Asambleja e Ortakeve të KAP Shpk. me unanimitet:

VENDOSI:

1. Te miratoje bilancin e vitit ushtrimor 2006 të paraqitur nga administratori;
2. Te miratoje pa rezerva shitjen tek Z. Albano Aliko të 82.5% të kuotave të shoqërisë KAP Shpk. të zotëruara nga ortaket Francesco Roggia 27.5%; Marcello Aloisi 27.5% dhe Massimo Carnevalli 27.5%;
3. Te pranoje dorëheqjen e administratorit të shoqërisë Z. Marcello Aloisi;
4. Te emërojë administrator të shoqërisë Z. Albano Aliko, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, me 02.06.1969, banues në Tiranë,

UNË NOTERI I SIGURT PËR IDENTITETIN E ORTAKEVE, TAGRAT E TYRE DHE ZOTËSINË E TYRE PËR TË VEPRUAR, LEXOJ ME ZË TË LARTE TEKSTIN E KËSAJ PROKURE. ORTAKET, ME NDIHMËN E PËRKTHYESË ME DEKLAROJNE SE KY AKT ËSHTË NË PËRPUTHJE ME VULLNETIN E TYRE TË LIRE E TË PLOTE DHE E NËNSHKRUAJNE ATË NË PRANINË TIME. UNË NOTERI E VËRTETOJ KËTË NËNSHKRIM SIPAS LIGJIT.

Marcello Aloisi

Francesco Roggia

Përfaqësuar nga Marcello Aloisi,

Përkthyes:


Massimo Carnevali

Përfaqësuar nga Av. Andi Memi

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

Përfaqësuar nga Z. Valentina


NOTERI



Andi Memi
Albi
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Përfaqësuar nga Z. Valentina
Stelios
Sokoloski

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar KAP Sh.P.K
Kapitali Themeltar: 3.777.511,50 Lek

NUIS: J62903833Q



VENDIM

I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE ORTAKEVE TE SHOQERISE
"KAP" Sh.p.k

Sot, ne Tirane, me 15 Nentor 2017, ne adresen Rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 10/2, ne oren 14⁰⁰, u mbajt Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve te Shoqerise KAP SHPK, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me NUIS-J62903833Q.

Rendi i Dites:

- ✓ Emerimi i Administratorit te ri te Shoqerise KAP sh.p.k duke qene se mandati i Administratorit aktual Z. ALBANO ALIKO ka mbaruar duke filluar nga data 17.05.2017;
- ✓ Propozimin per emerimin ne detyren e Administratorit te ri te Shoqerise te Z. Apostol GOCI, per nje mandat j 5 (pese) vjecar;
- ✓ Çeshtje te tjera lidhur me emerimin e Administratorit te ri te Shoqerise.

Jane te pranishem ne mbledhje:

- Z. Albano ALIKO, zoterues i 82,50 % (tetedhete e dy presje pese perqind) te kuotave te Kapitalit te Shoqerise;
- Ministria e Financave dhe Ekonomise, zoteruese e 17,50 % (shtatembedhete presje pese perqind) te kuotave te Kapitalit te Shoqerise; e cila perfaqesohet ketu nga Z. Alban BEQAJ, sipas Autorizimit nr. ¹⁵⁴⁸ / date 15.11.2017, leshuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomise, bashkelidhur ketij Vendimi;

Z. Albano Aliko verifikon njoftimet dhe konstaton se jane te pranishem ose te perfaqesuar ortaket qe zoterojne 100 % te kapitalit themeltar dhe deklarone asamblene te thirrur rregullisht dhe vendimet qe do te merren prej saj mbi ceshtjet e rendit te dites do te jene te vlefshme.

Pas diskutimesh ne lidhje me rendin e dites, Asambleja e Pergjithshme e Shoqerise:

VENDOSI:

1. Lirimin nga detyra e Administratorit të Shoqërisë, Z. Albano Aliko, duke qenë se mandat i tij ka përfunduar;
2. Emerimin e Administratorit të ri të Shoqërisë "KAP" shpk;
3. Emerimin për një afat 5 (pese) vjeçar në detyrën e Administratorit të ri të Shoqërisë, të Z. Apostol Miho Goçi, shtetas shqiptar, lindur më 1 Prill 1956, në Gjirokastrë, mbajtes i dokumentit të identifikimit nr. 028106713, banues në adresën: Rruga "Perlat Rexhepi, Pallati Unicom";
4. Mandati i Z. Apostol GOÇI do të fillojë nga data e nënshkrimit të këtij Vendimi, deri më datë 14 Nëntor 2022.
5. Ngarkohet Administratori i ri i Shoqërisë që vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar prej tij të vepronte në emër dhe për llogari të shoqërisë për depozitimin e këtij vendimi dhe akteve shoqërore të tij pranë QKB-se dhe Institucioneve të tjera.

Pasi nuk kishte më çështje për tu diskutuar, Kryetari deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve të mbyllur në orën 14:30.

Nënshkruhet, në Tiranë, sot më datë 15 Nëntor 2017 si më poshtë:

ORTAKET

Albano Aliko

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Perfaqësuar nga

Z. Alban BEQAJ

